

RENA ROSSI-ZAIRI  
**NJË DASHURI... HELM**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



RENA ROSSI-ZAIRI

NJË DASHURI... HELM

roman

Përktheu nga origjinali greqisht  
Albina Pulla

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Autore: ΠΕΝΑ ΡΩΣΣΗ-ΖΑΪΡΗ (Rena Rosi-Zairi)  
Titulli në origjinal: ΑΓΑΠΗ-ΔΗΛΗΤΗΡΙΟ  
Botoi në greqisht: PSICHOGIOS

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi  
Kopertina dhe përkuajesja grafike: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-29-9

© 2017 Psychogios Publications S.A.

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Të gjitha “Princeshave të Ngurosurat”,  
që gjejnë forcën dhe luftojnë  
me fatet e jetës së tyre...*



*Duhet të trokasim, të trokasim në derën e fatit tonë,  
derisa ajo të hapet dhe ne të shpëtojmë!*

*NIKOS KAZANTZAKIS*

*Letër El Grekos*

Botimet Kazantzaki, 2009





## *Gjurmë jete*

*Më pëlqen t'ju shpjegoj se si nisi çdo roman i imi, çfarë ishte ajo që më ngacmoi, që më bëri të zhytem në detin e të shkruarit. Këtë herë, arsyeja që më bëri të trajtoj marrëdhënie që lënë gjurmë të pashlyeshme përgjithmonë, është një mikja ime e ngushtë dhe të gjitha sa ajo përjetoi. Lidhja që kishte pasur dikur dhe që besonte se kishte marrë fund.*

*Por e kishte gabim.*

*Sepse është e vërtetë që një njeri, për të cilin besoj se të dashuronte, mund të ta nxijë jetën. Dhe kjo ndodh kur ai nuk pranon ndarjen, kur mendja e tij fillon e funksionon në mënyrë të rrezikshme, duke dashur të kënaqë egoizmin e tij të sëmurë. Ky njeri nuk është i kënaqur me jetën e tij, sado që beson të kundërtën. Nuk ndihet mirë me veten. Dhimbja dhe zemërimi nga ndarja e çojnë në shtigje të gabuara, e shtynë të lëndojë të tjerët, fizikisht dhe shpirtërisht.*

*E di që ekzistojnë shumë gra pranë nesh, që kanë përjetuar ose përjetojnë diçka nga të gjitha ato që përjetoj personazhi im.*

*Prandaj u përpoqa të kuptoja. U zgjua menjëherë brenda meje edukatorja. I vura vetes njëherësh shumë objektiva.*

*U mora me fëmijët që rriten duke parë babanë e tyre të ushtrorë dhunë fizike e psikologjike ndaj nënës së tyre. Me ata baballarë që duan të rrisin “burra”, fëmijë të shkatërruar psikologjikisht, para se të bëhen burra. Burra që kanë nevojë të dallojnë frikën në sytë e bashkëshortes së tyre, që të ndihen më shumë meshkuj.*

*Fëmija imiton prindërit e tij. Por, a jemi kopje besnike të prindërve tanë? A është e paracaktuar sjellja jonë? Nuk mund të përvijojmë rrugëtimin tonë personal? I përsërisim gabimet e tyre?*

*Ky roman “luan” me sjelljet dhe sekretet e shumta personale e familjare, që mpleksin jetë, ndjenja, vendime, plane.*

*Dhe personazhi i tij, Jasoni, luan me njerëzit.*

*Romani “Një dashuri... helm” trajton edhe dy çështje të tjera të mëdha: buliminë dhe zilinë.*

*Bulimia është më e shpeshtë se anoreksia nervore dhe, në përgjithësi, prek gjininë femërore. Njësohet me nevojën trupore që anashkalon logjikën dhe bëhet e pakontrollueshme. Është një mekanizëm i fuqishëm mbrojtës. Ndërsa zilia, në çdo formë që të shfaqet, trazon marrëdhëniet dhe, në raste ekstreme, mund*

*të shkatërrojë edhe vetë jetën tonë. Në të ndërthuren ndjenja të shumta dhe të ndryshme: tërbimi, pikëllimi, paplotshmëria, dëshpërimi, mosbesimi. Na bën që të vuajmë. Është një zjarr që na përvëlon përbrenda.*

*Si përfundim, marrëdhëniet njerëzore i vështirësojmë ne vetë. Por nuk ekzistojnë udhëzues përdorimi. Ekziston vetëm dashuria, që pret me durim, që fal dhe shpreson...*

*Romani “Një dashuri... helm” udhëton nëpër Egje, në ishujt Ko, Kalimno, merr në prehër Telendon, një ishull të vogël që ngjan sikur ka dalë nga Parajsa dhe nga një ëndërr e bukur. Por, mbi të gjitha, ky roman flirton me pasionin, me ndjenja të çmuara dhe me vlera jete.*

*Një falënderim të veçantë për Botimet Toena, për gëzimin që përjetova kur mora vesh se ky libër hapi krahët e tij dhe udhëtoi drejt një vendi shumë të bukur, Shqipërisë, për t’u bërë njësh me lexuesit e tij.*

*Në pritje të komenteve tuaja, uroj që t’ju lërë pa frymë ky roman me kthesat e tij të forta, t’ju emocionojë, t’ju ndihmojë që të bëheni, qoftë edhe për pak kohë, protagonistë të historive që trajton dhe të ndieni se rrugëtimi i jetës sonë është një dhe i vetëm: rrugëtimi i dashurisë.*

**Rena Rossi-Zairi**

**T**elendos, ishulli përballë meje, ishte zhytur në errësirë dhe më vështronte. Një masiv i dashur shkëmbor. Për herë të parë në jetën time po e vështroja ishullin, dhe u rrëqetha e tëra. Sepse mbante në prehrin e tij fëmijën tim.

A do ta shihja vallë pas disa orësh?

A do ta qetësoja zemrën e tij të vogël?

Ngrita kokën dhe vështrova lart. Princesha e Ngurosur bënte gjumin e përjetshëm, aty në majë të Telendosë. Fillova t'i bëja pyetje. Duke iu lutur të më përgjigjej.

A po e mbante fëmijën tim të mbështjellë në prehrin e saj?

Prisja të më përgjigjej. Të më thoshte diçka. Prisja me të vërtetë. O Zot! Kisha filluar të çmendesha!

Princesha e Ngurosur, natyrisht, nuk m'u përgjigj. Vazhdonte të flinte aty lart me të gjithë madhështinë e saj, pa u kushtuar rëndësi dramës së njerëzve nën të.

Dhe unë, shumë pak larg saj, shihja vazhdimisht orën e dorës. Çdo minutë që kalonte më dukej sa një shekull. U ula përtokë. Mbështeta kokën te gjunjët. U bëra njësh me molin, me kohën që ecte kaq ngadalë,

me lagështinë, me të ftohtin. Pak e nga pak fillova të humbas lidhjen me realitetin.

- Mirdita, vajzë!

U tremba. U ngrita në këmbë. Ishte i zoti i kaikes. E pyeta kur do të nisej.

- Mos u nxito! Të presim të vijë dhe ndonjë tjetër.

Të mos nxitoja? Ah, sikur ta dinte! Djali im më priste. Djali im. Do të ishte çmendur, vogëlushi im. O Zot, vetëm të ishte mirë! Të mos e kishte prekur i çmenduri.

Derisa të shfaqeshin dhe udhëtarë të tjerë, derisa të niseshim, derisa të arrinim në një distancë kaq të shkurtër, m'u duk sikur kaluan vite. Zbrita nga kaikja dhe mora rrugën që të çonte në shtëpinë e Jasonit dhe Mirtosë.

E dija ku ndodhej, nga përshkrimet e babait tim. Ah, ato vite të lumtura, ato vite të arta!...

Mund të ishte mëngjes, por dukej sikur ishte mbrëmje. Qielli i errët më bënte shoqëri. Si dhe një erë që po më ngrinte të tërën. Banorët e pakët të ishullit ishin ende të mbyllur në ngrohtësinë e tyre. Dhe unë kisha mbërritur në fund të udhëtimit tim të dhimbshëm.

Vila e motrës sime ishte një shtëpi shumë e bukur, e bardhë. Ndërtuar në njëfarë lartësie. Aty e mbante të burgosur fëmijën tim. Iu ngjita të përpjjetës me vrap.

U plasa mbi derën e jashtme me të gjithë peshën time. I rashë ziles me gjak të ngrirë.

- Jason! Jason! - bërtita dhe fillova t'i bie derës me forcë.

Nuk prita shumë.

- Më në fund! Mirë se erdhe në shtëpinë time të varfër! - tha dhe më hapi tejetej derën e madhe të drunjte.

Para meje nuk shihja asgjë. Vetëm njeriun që kishte rrëmbyer fëmijën tim. Kisha ngrirë në vend.

Pëllëmbët i kisha mbledhur grusht, gati për t'u përballur me të. Zemra ishte gati të më çahej. Sytë më digjnin. Koka më rrihte si çekan në mënyrë të pamëshirshme.

- Pas gjithë këtij udhëtimi që bëre, nuk dëshiron të hysh brenda? - më pyeti babai i fëmijës tim.

- Jason, ku është Mihali? - arrita ta pyesja më në fund.

- Hyr brenda dhe do t'i themi të gjitha. Do t'i bëjmë të gjitha. Të jesh e sigurt për këtë, - më tha duke buzëqeshur dhe më hapi rrugë që të kaloja.

Hyra brenda. U futa në gojën e ujkut.

Shtëpia ngjante me një pallat të vërtetë.

Këto nuk më interesonin. Iu afrova. E shkunda.

- Dua fëmijën tim!

Më përqafoi.

U tërhoqa.

- Dëgjo, vogëlushe, duhet të bisedojmë. Ç'ishin ato që më the në telefon? Ato budallallëqet që djali është i imi. Më gënjeve që të mos e prekja fëmijën, kështu është, apo jo?

- Nuk duroj dot më, Jason, ku është fëmija? - bërtita. - Pse ma bëre këtë?

- A do të pushosh së pyeturi vazhdimisht për të njëjtën gjë? Më thuaj. Duhet të më thuash, më gënjeve, apo jo?

Nuk u përgjigja.

Më kapi fort nga krahu dhe më drejtoi për në dhomën e ndenjjes, në errësirë. Shtëpia ishte e pandriçuar.

Më detyroi të ulesha në divan, përballë oxhakut që me flakët e tij ndriçonte ambientin. Ishte një oxhak gjigant. I ndërtuar me mermerin më të shtrenjtë. Donte dhe luks, dreqi.

U ul pranë meje. Ngjitur. Fryma e tij kutërbonte erë uiski.

- Dua fëmijën tim!

- Fëmijën tënd, apo fëmijën tonë?

E vështrova.

- Jason, të lutem. Të përgjërohem! Më thuaj, ku është Mihali? Këtu e ke? Do të jetë tërbuar djali. Më thuaj, të lutem, ku është Mihali?!

- Është djali im? - më pyeti përsëri.

E vështrova. Nuk doja t'i thosha përsëri të vërtetën. Fshihesha pas gishtit. E dija. Hapa gojën që t'i përgjigjesha, por fjalët nuk dilnin.

- Do të më thuash më parë ku është djali, e pastaj do të të përgjigjem, - arrita t'i them më në fund.

- Mojt qelbësirë! Më thuaj të vërtetën. Më thuaj nëse është djali im! Dua ta di! Është e drejta ime! - ulëriti.

- Ku është Mihali? - pyeta përsëri.

U ngrit në këmbë. U ngrita dhe unë.

Flakët e oxhakut reflektonin në fytyrën e tij. E bënin të ngjante me vetë djallin. Sytë e tij, të kuqe flakë, shkëlqenin nga pija, nga drita e zjarrit, nga zemërimi.

- Dua fëmijën tim! Ku e ke fshehur? - bërtita përsëri.

Më kapi nga duart dhe më shkundi.

- Është djali im? Është fëmija im? Më thuaj, pra?!  
- ulëriti.

- Po! - iu përgjigja me zë të këputur.

Dhe atëherë më gjuajti me shpullë.

Fort.

Më rrëzoi në divan. Ra mbi mua me gjithë peshën e trupit. Me njëren dorë shtrëngonte duart e mia mbi kokën time dhe me tjetrën filloi të zbrëthente pantallonat.

- Kjo është një gjë që doja të bëja prej kohësh! Që atëherë kur më braktise. Që atëherë kur ndryshova jetën time për hatrin tënd, - belbëzoi në veshin tim. - Je një bushtër! Një bushtër e poshtër! Këtë meriton!

Përpiqesha të shkëputesha prej tij. Nuk po mundej të zbrëthente rripin e pantallonave, dhe më liroi paksa. Bëra rezistencë me të gjithë trupin tim dhe arrita ta rrëzoj përtokë. U përpoqa të ngrihesha në këmbë që t'i shpëtoja, por ai më kapi nga flokët dhe filloi t'i tërhiqte me forcë.

Tani po përlesheshim në këmbë. Ishte burrë shumë i fuqishëm. Më gjuajti përsëri me shpullë. Çdo herë e më fort.



Në një moment e ngjiti trupin mbi timin. Dhe në atë moment gjeta rastin dhe e kafshova në fyt.

Fort, shumë fort.

Hungëriti dhe u bë gati të prekte vendin ku i dhembte. Arrita të marr frymë thellë. E shtyva larg vetes sime, sa më fort që munda.

Ku e gjeta gjithë atë forcë?

U lëkund. Humbi ekuilibrin, u pengua te tavolina që ndodhej para nesh dhe u shemb përtokë në kurriz, duke e goditur kokën me forcë te cepi i oxhakut prej mermeri. Dëgjova një zhurmë të mbytur.

Dhe pastaj asgjë.

Ndodhej i rrëzuar në dysheme. Nuk u ngrit më që të më sulej. U bëra gati të vrapoja larg tij, por diçka më ndali. E vështrova e trembur.

I ishte çarë koka.

- Jason, Jason! - ulërita me sa forcë më kishte mbetur.

Sytë e tij ishin të mbyllur. Nga koka e çarë rridhte gjak, që shpejt formoi një pellg të kuq në dysheme.

Iu afrova. U ula në gjunjë pranë tij. E tunda.

“Jo, jo!”, thashë me gjysmë zëri.

E kisha vrarë? E kisha vrarë!

Asnjeri nuk do të besonte që e bëra për vetëmbrojtje.

Do të më kapnin.

Krim? Krim!

# 1

## Stela

*Shtator 2014*

**S**humë njerëz mbrojnë idenë se çka është e destinuar të ndodhë, që është përcaktuar nga fati, është ajo që e drejton qenien njerëzore, pa mundur të reagojmë ndaj çfarëdolloj gjëje që na ka rezervuar e ardhmja. Thonë se jemi në mëshirë të fatit.

Dikur nuk isha dakord me këtë.

Sepse besoja plotësisht se kemi lirinë dhe mendjen që ta përcaktojmë sipas zgjedhjeve tona, se nuk ekziston asgjë e shkruar nga fati që më parë. Besoja se mund të çajmë jetën tonë, të bëjmë zgjedhjet tona. T'u rezistojmë pasioneve tona, të zbulojmë Itakën tonë, ashtu si Odiseja.

Derisa, para dy vjetësh e tre muajsh, fiks në qershor të vitit 2012, njoha Jasonin.

Dhe atëherë ndryshova krejtësisht mendim.

Ishte vallë e shkruar në fatin tim që të njihesha me të? Ishte zgjedhja ime të lidhesha me të? E kishte fajin fakti që më pëlqente të lexoja dhe turesha në çdo panair libri? Ah, nuk duhet të kisha vajtur atë verë në Pashaliman, që të informohesha për botimet e reja. Nuk duhet t'i kisha kushtuar rëndësi atij burri që m'u afrua me hapa të ngadaltë, të sigurt e më buzëqeshi.

Por i dhashë rëndësi.

Ishte zgjedhja ime apo lojë e fatit?

Kishte pamje të çuditshme. Më vështronte nga koka te këmbët, sikur po më skanonte. Kishte tipare të theksuara burrërore, i gjatë dhe trupmadh. Një burrë që nuk mund të kalonte lehtë pa rënë në sy. Sytë e tij, në ngjyrën e shkëlqyeshme të mjaltit, tepër të zgjuar, dhe flokët të dendur dhe me onde, kishin të njëjtën ngjyrë me sytë.

Nuk u largova. Nuk bëra asnjë hap mbrapa. E lejova të vinte pranë meje. Ndoshta do të duhej t'ia kisha dhënë vrapit. Ndoshta do të duhej të zhdukësja. Nuk e bëra. Nuk lëviza nga vendi.

Mbaj mend që edhe unë e vështroja dhe ndieja diçka të çuditshme. Sikur më bashkonte një fije e padukshme me të. Sikur i gjithë ai panair veror i librit në Pashaliman u bë vetëm e vetëm që të takoheshim ne të dy. U solla sikur po luaja në një film. Sikur prisja urdhrat e ndonjë regjisorit të padukshëm që të reagoja, të thosha diçka, të bëja diçka. Të gjithë njerëzit përreth meje më dukeshin si

figurantë. Burrat, gratë, fëmijët, që përkuleshin mbi banakët e stendave të shtëpive botuese të panairit, të cilat ishin të mbushura plot me libra.

Përfundimisht, nuk lëviza nga vendi. Thjesht dhe vetëm se thellë brenda vetes doja të më afrohej. Ndoshta ngaqë besova se Zotit i erdhi keq për mua. Dhe po përpiquej të më jepte një tjetër mundësi. Një mundësi që duhet ta rrëmbeja.

Isha njëzet e pesë vjeçe dhe prej shumë kohësh nuk isha e lidhur me ndonjë djalë.

Domethënë? Domethënë unë zgjodha t'ia ktheja buzëqeshjen kur m'u afrua. Dhe jo fati. Unë, që iu përgjigja pyetjes që më bëri.

Ishte diçka qesharake. Nuk e mbaj mend se çfarë. E vetmja gjë që mbaj mend është se ia plasa të qeshurës.

- Më quajnë Stela, - i thashë dhe i zgjata dorën.

Pa më detyruar askush.

- Më quajnë Jason, - m'u përgjigj ai dhe më zgjati dorën e tij.

Disi kështu nisi historia jonë.

U ulëm në një kafene përballë panairit dhe më qerasi me kafe. Nuk reshtëm së foluri. Sapo ishim njohur dhe dukej se kishim shumë për të diskutuar.

Përshtateshim. Përshtateshim?

Po nëse do ta dinim që më parë se njohja jonë do të na drejtonte drejt greminës?

Minutat kalonin, dielli kishte kohë që kishte perënduar dhe ne vazhdonim të flisnim e të flisnim, a

thua se kishim vite që njiheshim, a thua se nuk donim të ndaheshim.

Kur më në fund pashë orën e dorës, ora kishte vajtur dhjetë. U shastisa.

- Duhet të iki, - belbëzova.

Jasoni buzëqeshi.

- Edhe unë duhet të zgjohem shumë herët nesër, - më tha. U ngritëm dhe, pak para se të përshëndeteshim, shkëmbyem numrat e telefonit.

Në atë moment dëgjova një zë brenda meje që më ulërinte me dëshpërim:

“Jo! Jo! Mos e bëj këtë! Largohu prej tij sa më shpejt të kesh mundësi. Tani që mundesh! Ik! Mos guxo t’i japësh numrin e telefonit!”.

U çudita.

E injorova menjëherë këtë zë të çuditshëm dhe shkrova në një copë letër numrin e celularit tim. Nuk i kushtova vëmendje syve të Jasonit, që shkëlqenin çuditshëm sapo e mori dhe e shtrëngoi në grushtin e tij.

Po, i dhashë numrin tim të telefonit. Dhe ishte një gabim i madh, gabim fatal.

Por ka dhe rrethana lehtësuese për mua, apo jo? Se atëherë nuk dija se çfarë mund të më ndodhte. Si ishte e mundur ta dija?

Më telefonoi të nesërmen. U takuam përsëri e përsëri. Për të pirë diçka në ndonjë lokal, për të ngrënë në ndonjë restorant. Shkuam edhe në kinema. E adhuronim që të dy Robert de Niron. Në

një prej takimeve tona të rregullta, përfunduar në apartamentin tim.

“Ah, sa mirë do të ishte ta dashuroja me shpirt këtë njeri”, urova atë natë, që më ngjeshi, pak pa takt, që të them të vërtetën, në divanin e dhomës sime të ndenjjes.

Bëmë dashuri për herë të parë.

Lidhja jonë vazhdoi. Dilnim, shëtisnim, e pastaj përfundonim në krevatin tim. Herën e katërt, të pestë, ndoshta dhe të gjashtë, nga dita kur e mirëprita në shtëpinë time, befas vura re veglat e tij të rrojës në banjën time.

Briskun, kremin pas rrojës, parfumin. Të gjithë kompletin e rrojës!

I vështrova e çuditur. Nuk dija çfarë të mendoja. Nuk dija ç'të bëja. Dëshiroja të bashkëjetoja me të?

Po. Pse jo? Mendova. Përse të mos i jap një mundësi? Kushedi? Ndoshta mund të jetë burri i jetës sime. Një dhe i vetmi.

Ai kompleti i veglave të rrojës e kishte fajin. Dhe ato mendimet e mia, që e futën me të vërtetë në përditshmërinë time.

Derisa erdhi dita, erdhi momenti që nuk doja ta shihja më kurrë gjatë gjithë jetës sime atë njeri.

Diçka shumë e vështirë. Ndoshta dhe e pariparueshme.

Që atëherë, çdo mëngjes, sapo zgjohem, mendimi i parë që më pushton, që më mbush me pasiguri,

është një dhe vetëm një: se nuk mund të shpëtoj një herë e përgjithmonë nga ai.

Zgjohem dhe mendoj se është e pamundur që të isha bërë njësh me atë njeri, ta kisha dashuruar. A e dashurova vallë? Pse e futa në jetën time? Pse pranova të më prekte?

Çdo ditë. Çdo minutë. Ashtu si dhe sot.

Dy vjet dhe tri muaj më pas.

Marr frymë thellë dhe ngrihem. Ora është gjashtë e mëngjesit. Duhet të përgatis mëngjesin. Mihali duhet të jetë gati në orën shtatë. Duhet ta çoj në kopsht. Dhe pastaj të buzëqesh gjithë kohës me edukatë, t'u shërbej klientëve të bankës, të kaloj edhe një tjetër ditë.

Të duroj...

Vogëlushi, i sapozgjuar nga gjumi, më vështron me adhurim. Është pika kulmore e jetës sime, është forca ime lëvizëse. Arsyeya e vetme që buzëqesh përsëri. E rrëmbej në krahët e mi dhe filloj të rrotullohem nëpër dhomë. Ai shkrihet së qeshuri.

Papritur bie zilja e telefonit.

Mendoj gjëra pa lidhje që të kalojnë sekondat. Që të mos bjerë më. Që të mos dëgjoj më atë tingull të mallkuar.

Jo! Nuk do ta ngre receptorin. Nuk dua ta ngre. Mihali më vështron. Megjithëse është gjashtëmbëdhjetë muajsh, e di që kur dëgjohet ky tingull, ngremë receptorin. E kupton që jam trembur. E kupton, madje, edhe se si ndihem, sikur është pjesë e trupit tim.

Më vështron i trembur, i habitur.

I buzëqesh aq sa mundem, në një mënyrë që të qetësohet. Kështu si tronditem unë sa herë që bie zilja e telefonit, një ditë djali sapo ta dëgjojë zilen, do të trembet. Një sërë librash pedagogjikë kam lexuar në lidhje me edukimin e drejtë të fëmijëve. A nuk thonë se fëmijët imitojnë prindërit? Përpyekjet e tyre? Frikën e tyre? Vogëlushi im më imiton. Duhet të mësoj të përballoj ankthin. Tashmë jam nënë. Kam detyrime. Mijëra përgjegjësi. Por si mund ta bëj që të kuptojë se nuk mund ta përballoj babanë e tij?

E mbështes përsëri në krevatin e tij. Dal me vrap nga dhoma e tij që të mos më shohë se sa e tronditur jam, dhe futem në dhomën e ndenjjes. Aty ndalem.

I afrohem me ngadalë aparatit të telefonit.

E di që është budallallëk, por besoj se nëse vonoj t'i afrohem, zilja nuk do të bjerë më. E kam gabim. Tingulli i tij më shpon veshët.

I vazhdueshëm, acarues, rrëqethës.

Nuk mund ta dëgjoj më. Ngre receptorin dhe, po, është ai. Burri që urrej. Është zëri i tij karakteristik.

Nuk është e nevojshme të flas. Ai e di që jam unë.

- Do ta paguash, - më thotë.

Toni i zërit të tij është i ashpër dhe shpreh vetëkënaqësi. Keqdashës.

Dëgjoj. A mund të bëj ndryshe? Zemra ime rreh si e çmendur. Tashmë e di shumë mirë se si mund të më trembë.

E di...

Marr frymë thellë. Nuk përgjigjem. Pastaj e ul receptorin sa më fort që mundem.



E di që edhe sot ia bëra qejfin.

Ai e di që dhe sot më bëri të dridhem e tëra...

*Gusht 2012*

Ishulli Kos shtrinte me nge trupin e tij në detin e qetë ngjyrë blu. Eukaliptet e larta me trupat e drejtë në rrugën kryesore për në Psalidë, qëndronin krenare, duke përpirë me sy nga lart turistët. Gjethet e tyre tundeshin nga fladi që u këndonte me zë të ulët serenata verore. Bletët gumëzhinin të lumtura. Thithnin pa e vrarë mendjen nektarin e luleve të tyre të bardha, të brishta e plot aromë.

Këto pemë i njihnin mirë turistët. Gjatë muajve të verës janë pjesë e pandarë e jetës së tyre. Janë mësuar të dëgjojnë gjuhët e tyre të çuditshme, përpiqen t'u urojnë mirëseardhjen me çfarëdolloj mënyre që mundën. I freskojnë me hijen e tyre, largojnë mushkonjat dhe gjatë ditëve të nxehta iu rigjallërojnë mushkëritë me aromën që lëshojnë gjethet e tyre.

Muajin e fundit të verës turistët e huaj mund të thuash se e pushtojnë gjithë ishullin. Pushuesit grekë nuk janë të shumtë. Vendasit i bëjnë pushimet në dimër. Gjatë verës punojnë pa pushim ditë e natë. Punojnë në zyra turistike, hotele, restorante, supermarkete, anije turistike, dyqane që japin me qira motorë dhe biçikleta, shumë biçikleta, në një ishull që ndan me bujari thesaret e tij, që shpalos rrugë të panumërta për t'i zbuluar. Gjatë periudhës së versë jeta në Ko ngjan si në përrallë.

Edhe ai gusht rridhte normalisht dhe atë muaj ishulli përjetonte legjendën e tij, duke shijuar admirimin e vizitorëve të tij. Nota të panumërta të lashtësisë, nota të pushtimit otoman, dhe pak, tashmë në nivelin minimal, nota italiane, konfigurorin edhe për sivjet pentagramin e një prej vendeve më “ekzotike” të Greqisë.

E dashuroja ishullin Ko. E njihja mirë që kur isha fëmijë. Ishte pjesë e vetë jetës time. Kaq i ndryshëm nga ishulli ku kisha lindur, Kalimno, që qëndron kryelartë vetëm pak milje larg tij.

Ishujt Ko dhe Kalimno. Dy ishujt të Egjeut kaq afër me njëri-tjetrin, por edhe kaq të ndryshëm. A thua se Zoti i krijoi enkas kështu, që të plotësojnë njëri-tjetrin. Secili kishte karakterin e tij, personalitetin e tij. Tokë pjellore, fusha të pamata plot gjelbërim, me bimësi të shumëllojshme, shumë burime dhe pllaja, rrugë që të sjellin ndër mend bulevarde, në ishullin e Hipokratit. Tokë malore dhe jopjellore, që e bënin të vështirë mbjelljen e kulturave bujqësore, pak lugina gjatë bregut, shkurre, shkëmbinj, shkëmbinj gjigandë dhe rrugë të ngushta, në ishullin gjuetarëve të sfungjerëve të detit.

Secili ishull me bukurinë e tij, veçoritë e tij, madhështinë e tij, me bukuritë e tij të dukshme e të padukshme.

Kur diskutuam me Jasonin se ku do t’i kalonim ato pak ditë pushimesh, zgjedha menjëherë ishullin Ko, pa e menduar për të dytën herë. Vetëm dhjetë ditë kishim në dispozicion. Doja të skalisja në kujtesën

time ishullin që dashuroja, në shoqërinë e atij burri që sapo kishte hyrë në jetën time si një tornado. Doja të njihja karakterin e tij në një vend kaq të dashur për mua, në një vend që sa herë që e vizitoja, ndieja diçka të veçantë.

Ko është për mua një dhuratë e paketuar me letra të panumërta, që i hap me ngadalë për të parë se çfarë fshihet brenda. Të provokon të zbulosh gëzimet e tij të fshehta, të entuziazmohesh, të mbetesh gojëhapur nga çudia.

Jasoni nuk kishte qenë asnjëherë në Ko, dhe ideja i pëlqeu menjëherë.

Zgjidhëm një prej hoteleve më të bukura të Psalidës, afër qendrës së qytetit. Çaste magjike pranë detit, dashuri nën dritën e hënës, shëtitje të panumërta me biçikletë. Çdo ditë zbulonim dhe një vend të ri, çdo ditë bëheshim njësh me diellin, shkujdesjen verore, me lumturinë.

- Ç'je një ti! Ishe e sigurt që do të më pëlqente ky ishull, apo jo? - më pyeti një mbrëmje.

Po pinim diçka në breg të detit. Pastaj pimë edhe një, edhe një. Bari i hotelit tonë i kishte karriget të vendosura brenda në det. Një prozhektor gjigant ndriçonte rërën, i dhuronte një ngjyrë ireale. Hëna rrëshqiste në ujërat e qeta dhe atyre u merreshin mendtë nga ngjyra e saj hyjnore dhe ia kthenin buzëqeshjen.

Magjia e detit të Egjeut.

- Është një ishull që u pëlqen të gjithëve, - belbëzova duke buzëqeshur. - Sidomos nëse di mënyrën për të

qëndruar larg turistëve që e mbushin atë. Por, a ka ishull grek që të mos jetë i bukur? - vazhdova.

Po pyesja veten se përse flisja në mënyrë kaq të zakonshme.

- Edhe shkretëtira do të më dukej parajsë pranë teje, vogëlushja ime, - u përgjigj ai dhe më puthi me delikatesë.

Mbylla sytë dhe mora frymë thellë.

Që qershorin e kaluar, që atëherë kur Jasoni hyri në jetën time, koha kalonte shumë shpejt. Isha mësuar të jetoja vetëm, prandaj dhe u çudita. Më çudiste, madje, dhe mënyra sesi ia dilte të më bënte si të donte ai, pa e kuptuar.

Sesi bënte gjithmonë atë që donte.

Nuk më pyeti nëse doja të rrinim bashkë, nëse pranoja të bashkëjetojmë. Vetëm një natë e teprova, e lejova të rrinte në shtëpinë time, dhe në mëngjes, kur iku për në punë, pashë kompletin e veglave të rrojës në banjën time. Nuk i kushtova shumë rëndësi. Por disa ditë më vonë u tërbova kur pashë edhe gjëra të tjera të tij. Në dhomën time të gjumit, në sirtarin e dollapit, kishte lënë disa të brendshme. Dhe në kuzhinë, pranë *corn flakes*, që ishin të preferuarat e tij, më priste një kupë me shenjën e skuadrës së tij të dashur.

Si ia kishte arritur? Si i kishte sjellë të gjitha këto pa kuptuar unë asgjë?

Kaq befasisht dhe në mënyrë të papritur u vendos në shtëpinë time. Dhe filloi të sillej sikur i përkiste atij. Ishte avokat, zyra e tij ndodhej në bulevardin

“Kifisia”, dhe kishte marrë me qira një apartament të vogël në Eksarhia. U vonova paksa për të biseduar në lidhje me çështjen që kishte të bënte me të, ta pyesja se pse hidhte andej-këtej gjërat e tij, derisa një mëngjes më informoi se do të jetonim bashkë.

Një prej defekteve të mia është edhe pavendosmëria. E doja pranë vetes? Do të mërzhitej nëse do ta pyesja pse kishte sjellë kaq gjëra të vetat në apartamentin tim? Më në fund gjeta kurajën dhe ia bëra pyetjen.

- Humbas shumë orë rrugëve. Kështu që do të rri këtu, në shtëpinë tënde, në Marusi. Më vjen për mbarë që gjendet shumë afër me bulevardin “Kifisias”. Përveç kësaj, do të të ndihmoj dhe me qiranë, - më tha.

Nuk priti të dëgjonte përgjigjen time.

Dhe kështu, pa e kuptuar mirë, u bëra me bashkëjetues. Ngaqë nuk doja ta bëja të ndihej keq. Nuk më bënte zemra ta mërzhisja. I lashë gjërat të merrnin rrugën e tyre, megjithëse thellë brenda vetes e dija që po gaboja, se shpejt do të pendohesha.

Gjatë asaj periudhe po kërkoja punë. Kriza kishte shtrirë rrënjët thellë në vend, papunësia kishte arritur shifra të larta. E kisha përgatitur veten se mund të vija në provë aftësitë dhe dijet e mia në ndonjë punë që mund të mos kishte domosdoshmërisht lidhje me çfarë kisha studiuar.

Që të them të vërtetën, nuk e dija nëse doja ta zboja. Kisha filluar të mësohesha të jetoja me të. Për më tepër, paratë që prindërit e mi kishin depozituar në

llogarinë bankare, kishin filluar të pakësoheshin. Ishte njëfarë lehtësimi që Jasoni të paguante gjysmën e qirasë.

Sigurisht, babai im nuk do të kishte asnjë kundërshtim të më ndihmonte edhe më ekonomikisht. Por sa herë që më pyeste, i thosha se nuk kisha asnjë problem. E dinte që përktheja literaturë të shkencave ekonomike, dhe fitoja disa pará. Nuk doja ta rëndoja më shumë. Kishte shpenzuar shumë pará për mua. Që në momentin kur u largova nga Kalimno, vendi ku u linda dhe u rrita, dhe erdha në Athinë për të studiuar në Fakultetin Ekonomik, nuk kishte reshtur së ndihmuari. Paguante qiranë e apartamentit të vogël diku në lagjen “Kipseli”, dhe kur u diplomova më pagoi edhe shpenzimet për të kryer studimet pasuniversitare në një prej universiteteve të Anglisë. Furnizonte vazhdimisht llogarinë time në bankë.

Kur mbarova studimet jashtë shtetit, vendosa të banoja larg qendrës. Zgjodha zonën periferike në veri. Mora me qira një apartament me dy dhoma gjumi në Marusi, afër Stadiumit Olimpik, duke besuar se do të gjeja shpejt punë. Por gabova.

Dhe ditët rridhnin në shoqërinë e Jasonit, me vrapimet dhe ankthin tim në kërkim të punës.

Nuk kisha dëshirë për të shkuar me pushime. Nuk shkojnë bashkë rehatia dhe moskokëçarja me papunësinë.

Por Jasoni këmbënguli.

- Dhjetë ditë nuk ndikojnë dhe aq në projektbuxhetin e shpenzimeve të tua, - më thoshte vazhdimisht, derisa më bindi.

Nuk u pendova që më në fund ndoqa këshillën e tij, shtrihesha në rërë dhe largoja nga mendja problemet e kryeqytetit. I tregova Jasonit çdo skaj të ishullit që dashuroja. Që në momentet e para, madje, që shkelëm në ishull, u zhytëm në qetësi, në paqe, në argëtim. E shëtitem qendrën historike të qytetit, vendet arkeologjike, Tregun Popullor.

Ko ngjan me një park gjigant arkeologjik. Monumentet e lashtësisë dhe vendet arkeologjike janë të shpërndara gjithandej, kudo që t'i kthesh sytë, bëhen njësh me ngjyrën e kaltër të qiellit dhe të detit.

Shëtitem ambientet mesjetare të kështjellës së Kalorësve, ecëm nëpër qytetin e vjetër, shijua gatime të Azisë së Vogël te Platani apo Kermetea, lagjja e vjetër turke e ishullit. Vizitua Asklipion, monumentin më të famshëm të ishullit Ko, që gjendet tre kilometra jashtë qytetit. Shtrihet në faqet e një kodre, është plot me pemë, në një pikë me pamje të mrekullueshme drejt brigjeve të Azisë së Vogël. Aty njohu zhvillim mjekësia shkencore, falë shkollës që kishte themeluar në ishull Hipokrati, përfaqësuesi më i rëndësishëm i mjekësisë në lashtësi. Admironim, madje, edhe Rrapin në qytetin e Kosë, një prej pemëve më të vjetra të botës, pasuronim çdo ditë eksperiencat tona.

Mëngjesin e ditës së tretë të pushimeve tona, dhe ndërkohë që po përgatiteshim të shkonim në ekskursion në Kefalo, një ndër vendet më mbresëlënëse të ishullit, me brigje të pafundme, me rërë të artë, ra zilja e celularit tim.

- Zonjën Stela Damianu, ju lutem, - tha një burrë me një zë zyrtar.

Ishte nga një bankë private ku kisha bërë kërkesë për punë. Po më thërrisnin për intervistë. Po afrohej 15 gushti. Ishte e mundur të bëheshin intervista në ditë të tilla? Por nuk mund të kundërshtoja. Duhej të shkoja, duhej.

Kur vendosa celularin mbi komodinë, në krah të krevatit dopjo, Jasoni më vështroi i çuditur.

- Nuk e besoj dot! Je mirë? Dëgjova mirë? I the që do të shkosh? Nesër? E pabesueshme! Po pushimet tona, vogëlushja ime...

E përqafova.

- Mos u shqetëso! Vetëm një ditë do të mungoj. Do të iki sot pasdite me avion. Besoj se do të ketë vende të lira për në Athinë. Shpresoj t'ia arrij që të kthehem nesër në darkë.

Nuk më besoi, por për fat të mirë nuk më kundërshtoi.

Para se të niseshim për në Kefalo, kaluam nga një zyrë turistike. Gjeta menjëherë biletë për në Athinë. Por agjenti më zhgënjeu për kthimin.

- Biletat nga Athina për në Ko janë të shitura. Prej muajsh. Do ta vendos emrin tuaj në listën e pritjes. Uroj të jeni me fat. Mos u shqetësoni dhe mos harroni se mund të ktheheni me tragetin e linjës, - më tha.

Nuk më ngushëlloi.

I dhashë numrin e celularit tim që të më informonte nëse do të gjendej ndonjë vend. Përparësia ime e parë ishte të ikja nga ishulli. Të



shkoja në mëngjes për intervistën, të përpiqesha të filloja punë. Gjithë të tjerat vinin pas kësaj. Në fund të fundit, mund të kthehesha dhe me traget, dhe le të më duheshin rreth dymbëdhjetë orë. Nëse do të gjeja punë, do të kthehesha edhe me not, madje, nga Pireu në Ko!

Nuk ia përmenda Jasonit vështirësinë me biletën e kthimit. Pak para se të arrinim në Kefalo, u kthyem dhe zbritëm në plazhin e bukur të Shën Stefanit. Në Ko ka një numër të konsiderueshëm bazilikash paleokristiane. Nga të gjitha ato që janë zbuluar nga gërmimet arkeologjike, bazilika e Shën Stefanit është më madhështorja dhe e ruajtur në gjendjen më të mirë. Bëhet fjalë për një kompleks dy bazilikash, të ndërtuara mbi një shkëmb. Ndodhen në breg, përballë ishullit të vogël Kastri, që ngjan me një fortifikatë, në majë të së cilës ndodhet kisha e vogël piktoreske ngjyrë bojëqielli e Shën Nikollës. Të gjitha këto së bashku luajnë rolin kryesor në krijimin e peizazhit, duke kompozuar një skenar përrallor.

Kolonat e bazilikës së Shën Stefanit janë prej mermeri të bardhë dhe kanë kapitete të stilit jonik. Janë akoma në gjendje të mirë, prej shekujsh tashmë ato ndriçohen nga drita e diellit. Mozaikët e faltores, shqiponja dhe palloj, janë të mbuluar në mënyrë që të mbrohen nga agjentët atmosferikë. Numërojnë momentet dhe vitet që kalojnë, janë dëshmitarë të ngjarjeve madhështore të së kaluarës, që tashmë janë harruar.

Gjirin e mbyllur të Shën Stefanit e përshkojnë motoskafe të panumërt, që tërheqin notarët dhe i ndihmojnë që të shkëputen e të ngjiten lart me parashutat e tyre shumëngjyrëshe. Këtu, njëra epokë ndërthuret me epokën tjetër dhe gjithçka ngjan me një mrekulli.

Por, me gjithë ato bukuri të paimagjinueshme rreth nesh, Jasoni vazhdonte të qëndronte turivarur. Nuk mund ta pranonte se nuk ishte në qendër të botës. Nuk ishte i papunë, nuk ia dilte të ndante bashkë me mua ankthin tim.

Nuk flisnim shumë.

Shihja orën vjedhurazi. E dija që nuk kisha shumë kohë në dispozicion. Duhej të ktheheshim në qytetin e Kosë, në hotel, dhe pastaj të nisesha për në Antimahia ku ndodhet aeroporti. Fluturimi im për në Athinë ishte në orën katër pasdite.

Notuam në ujërat ngjyrë jeshile, arritëm deri te ishulli i vogël, bëmë banjë dielli, vizituam faltoren, bëmë fotografi.

Në orën një Jasoni u ankua se kishte uri.

- Ngaqë na hutove me atë agjencinë tënde nuk arritëm të hanim as mëngjes. Harrove? - u ankua.

Ecëm pak më lart se bregu me rërën ngjyrë ari. Mbrapa disa kallamishteve të larta dallooi një tavernë. Kishte tavolina dhe karrige kashte të lyera ngjyrë blu të errët. Ishte një pamje kaq idilike.

Stomaku më shtrëngonte nga padurimi, nuk mund të kapërdija asnjë kafshatë. Ajo që dëshiroja ishte

të gjendesha sa më shpejt që të ishte e mundur në Athinë, që të arrija të bëja intervistën. Por nuk doja t'ia prishja qejfin Jasonit.

Porositi peshq të freskët. U përpoqa të mos merrja frymë me vështirësi dhe e detyrova veten të qetësohej e të buzëqeshte.

Papritur buzëqeshi edhe Jasoni. Më vështroi me një pamje prej naivi të gëzuar. U habita. Në atë çast kamerieri vendosi në tavolinën tonë dy birra të ftohta. Nuk arriti të largohej, dhe Jasoni u përkul e më puthi nxitimthi.

- Do të presësh edhe pak, nuk do të pish. Dakord?  
- belbëzoi.

- Kam etje, - iu ankova, e gëzuar që e kishte mundur egoizmin e tij.

- Edhe unë kam etje për ty, vogëlushja ime. Dhe dua të trokasim gotat për lumturinë tonë, - më tha gjithë pasion.

Pastaj u përkul dhe nxori nga çanta e plazhit një kuti të vogël të kadifenjtë.

Një kuti bizhuterish.

E humba toruan. O Zot, jo! Nuk ishte e mundur!

- Doja të ta bëja surprizë sot në mbrëmje nën dritën e hënës, - filloi të më thoshte. - Por vendose të më lësh vetëm, dhe kështu, që të të dënoj, do të ta bëj edhe unë propozimin këtu.

- Propozim? Çfarë propozimi? Jason... çfarë do të thuash? - e pyeta, ndërsa zemra filloi të rrihte me forcë në kraharorin tim.

- Stela? Vogëlushja ime? Do të dëshiroje të bëheshe gruaja ime? - më pyeti dhe hapi kutinë.

Dallova një unazë shumë të bukur që shkëlqente. Ishte e tëra prej floriri, me një gur të çmuar, në ngjyrën e detit.

Mbeta pa frymë.

Me Jasonin kishim rreth dy muaj që njiheshim. Kishte ndërhyrë një herë në jetën time. E kisha lejuar, por...

Por gjithçka ka kufij.

Të gjitha kishin ndodhur kaq shpejt dhe papritur. Nuk kisha arritur ta njihja, të kuptoja karakterin e tij të vërtetë. Nuk kisha vendosur nëse doja të kaloja me të pjesën tjetër të jetës. Që në momentin kur u njohëm te panairi i librit dhe hyri në jetën time pa më pyetur, u bëmë të pandarë.

Vështroja unazën si idiote. Nuk dija çfarë të bëja. Nga njëra anë, më vinte të ulërija nga gëzimi, nga ana tjetër, t'ia mbathja vrapit.

Po përse?

Pse vallë me një gjest të vetëm deshi të shkatërronte atë lidhje që kishim bashkë, pavarësisht si mund të ishte ajo? Përse nxitohej kaq shumë?

- Stela? Stela ime? - pëshpëriti dhe u përpoq ta vendoste unazën në dorën time të majtë.

Topazi shkëlqeu edhe më shumë. U tërhoqa. I fsheha me nxitim duart poshtë tavolinës.

- Unë... unë nuk e di... - belbëzova.

Nuk di asgjë për ty, doja t'i thosha. Por nuk guxova.

Me të vërtetë që nuk dija asgjë për të. Si është e mundur të martohesh me një të panjohur? Nuk më kishte përmendur as gjënë më të vogël për veten, familjen, për besimin e tij. Më kishte thënë vetëm që kishte mbushur tridhjetë vjeç. Dhe as nuk kishim diskutuar ndonjëherë për të ardhmen tonë të përbashkët. Nuk më kishte kaluar nëpër mend. Që të them të vërtetën, as unë nuk ia kisha hapur zemrën. Ishte shumë herët. Kisha përmendur vetëm që familja ime, gjatë pjesës më të madhe të vitit, jeton në ishullin ku u linda, në Kalimno. Asgjë më shumë. Nuk i kisha thënë as që kisha një motër.

- Je mirë? - më pyeti papritur dhe më bëri të shkëputesha nga mendimet e mia.

E hodha vështrimin mbi të. Më vështronte edhe ai me një pamje të vrazhdë. Një zë brenda meje çirrej që të ikja me vrap. Të ikja me vrap e të ndaloja kur të sigurohesha që kisha shpëtuar nga ai burrë. E njihja mirë atë zë. Ishte i njëjtë me atë që më paralajmëroi të mos i jepja numrin e celularit kur sapo u njohëm, kur ma kërkoi.

U kapërdiva.

- Jason, më bëre të humbas toruan. E kam me të vërtetë, - belbëzova.

Shprehja e fytyrës i ndryshoi menjëherë.

- Pse, moj budallaçkë, - më tha me ëmbëlsi, duke mbajtur unazën ende në dorë. - Një grua tjetër, po të ishte në vendin tënd, tani do të fluturonte në qiell. Unë, zemra ime, dua të krijoj shpejt familje. Dua të

bëjmë dy-tre fëmijë. Që në momentin e parë që të pashë, e kuptova se ti je gruaja që dëshiroj të lindë fëmijët e mi, ti je...

Vazhdoi të fliste dhe të më radhiste dëshirat e tij. Por fjalët e tij më bënë të dridhjesha e tëra e jo të fluturoja në qiell, ashtu siç donte ai.

Ishte i çmendur?

Duhej ta kundërshtoja. Dhe shpejt, madje. Sapo kisha mbushur njëzet e pesë vjeç. Nuk mendoja ende për martesë. Fëmijët i doja. Dikur do të krijoja edhe unë, disi, familje. Por tani? Jo, jo! Në asnjë mënyrë.

Duhej të gjeja një punë, një punë të mirë e të vazhdueshme. Duhet ta njihja burrin e ëndrrave të mia. Dhe nuk isha e sigurt nëse Jasoni ishte njeriu me të cilin do të doja të jetoja. Sapo më kishte njohur. Si ishte e mundur të besonte që isha gruaja me të cilën donte të martohej dhe të bënte me të dy-tre fëmijë?

- Nuk... nuk dua të martohem që tani, - më shpëtoi.

Ndaloi papritur së foluri. U zbeh.

- Çfarë nënkupton?

- Nuk nënkuptoj asgjë, Jason. Të falënderoj për unazën, për propozimin, për gjithçka. Të falënderoj shumë, por...

- Por, nuk do të martohesh me mua. Apo jo? - më ndërpreu.

- Nuk thashë diçka të tillë.

- E the, si nuk e the, - belbëzoi i inatosur.

- Më dashuron? - e pyeta papritur.

Pyetja ime ishte e pakuptimtë. U pendova, por ishte vonë.

- Po. Të dashuroj.

Buzëqesha.

Më dashuronte? Si mund të dashurosh një njeri pa e njohur? Preferoja një mijë herë më mirë të më thoshte se më dëshironte, më donte, ishte i pasionuar pas meje.

Ishte menduar mirë kur i doli nga goja ajo folje kaq e vyer? E kishte fajin entuziazmi i tij? Mendjelehtësia e tij?

- Dëgjo, Jason. Edhe një herë tjetër, dua të të falënderoj për propozimin tënd. Më nderon. E kam me të vërtetë. Por, duhet të jemi të sigurt që nuk po bëjmë ndonjë gabim. Njihemi shumë pak. Nuk kemi as dy muaj që jemi lidhur. Si je i sigurt që jam gruaja e ëndrrave të tua, dhe nuk po bën ndonjë gabim?

- Të paktën po numëron ditët që jemi bashkë, diçka do të thotë edhe kjo, - belbëzoi i zhgënjyer.

- Po, diçka është, - thashë.

Se nuk dija ç'të thosha tjetër.

Nuk foli. Rrëmbeu kutinë nga tavolina, vendosi brenda në të unazën dhe e hodhi në çantën e plazhit.

- Nuk dua të shkosh në Athinë, - tha duke ndryshuar papritur temën e bisedës.

E humba toruan.

- E ç'lidhje ka kjo me propozimin që më bëre? - e pyeta.

Isha kaq kureshtare të dëgjoja përgjigjen e tij.

- Këtë unazë e bleva në Athinë. Doja të ta dhuroja ditën që do të mbusheshin dy muaj nga njohja jonë. Që ta vendosësh në gisht me krenari, që të jesh zyrtarisht e dashura ime. Por...

- Por sapo dëgjove që duhet të iki për pak, mendove të më bësh propozim për martesë. Përse? Që të mos arrij avionin, apo jo? - e ndërpreva.

- Sidoqoftë ne do të martohemi. Nuk do të martohemi? Tani, apo më vonë, nuk ka shumë rëndësi. Pse, pra, e zgjat kaq shumë, pse e zvarrit? - më pyeti me siguri absolute në zërin e tij.

Mbeta gojëhapur, e çuditur nga ato që më tha. Nuk dija nëse duhej të qeshja apo të nxehesha.

U ngrita papritur në këmbë.

- Më bëj një nder dhe thuaji pronarit të tavernës që përfundimisht nuk do të hamë. Thuaji të na sjellë llogarinë dhe... do të të pres te makina, - thashë dhe u largova nga tavolina.

U futa me nxitim në makinë dhe e mbylla derën me forcë. Doja shumë të ulesha te vendi i shoferit dhe të zhdukësja e ta lija vetëm, le të gjente një grua tjetër, ta dashuronte për dy muaj dhe t'i propozonte të bëhej nëna e fëmijëve të tij.

Kur më në fund u ul pranë meje dhe ndezi motorin e makinës, kishte ndryshuar qëndrim. Ishte gjithë qejf. Megjithëse kishte mbetur pa ngrënë, megjithëse do ta lija vetëm pas disa orësh. Nuk tha asnjë fjalë për unazën dhe për propozimin që nuk e pranova. Për aq kohë sa na u desh të arrinim në hotel, as unë nuk thashë ndonjë fjalë për “zënkën” tonë të parë.

E lashë të fliste ai, të thoshte ç'të donte ai.

Por shumë shpejt u qetësova dhe filloi të më brente ndërgjegjja. Nuk është se më bëjnë çdo ditë propozim



për martesë. Nuk më ofrojnë unaza të shtrenjta me gurë të çmuar. Dhe, në fund të fundit, nuk donte të më bënte keq. Të bëhesha gruaja e tij donte.

Buzëqesha.

E shihja që i jepte makinës, dëgjoja gjithçka që thoshte për një udhëtim të tij në Rodos dhe se sa shumë ia kujtonte Koja, dhe mendoja se sa të çuditshëm janë njerëzit.

Çfarë mendonte vallë ai për mua? Se jam ndonjë e lojtur, që do t'i dalë gjithnjë e saja? Se nuk dija ç'kërkoja nga jeta?

Mikja ime më e ngushtë, Elena, do të shkrihej së qeshuri nëse do të merrte vesh se çfarë më kishte ndodhur sot. Në atë periudhë po bënte një tur në Spanjë me të dashurin. Kishin dy vjet të lidhur me njëri-tjetrin dhe ende nuk kishin biseduar për martesë. Kishin kohë që kishin ikur, kishin vendosur të vizitonin shumë vende të Europës me tren, derisa t'u mbaronin paratë. Elena nuk e dinte që edhe unë isha e lidhur me dikë. I kisha thënë vetëm disa gjëra para se të ikte. Se kisha njohur një tip, dhe se kisha filluar të dilja me të. E si mund t'i thosha, që edhe do të martohesha me të?

Kur arritëm më në fund në hotel dhe mbyllëm derën e dhomës, Jasoni më përqafoi gjithë pasion.

- Më fal, - më tha.

- S'është nevoja të më kërkosh falje, - pëshpërita.

- Thjesht duhet të pranosh se propozimi që më bëre ishte disi i parakohshëm dhe...

Nuk më la të vazhdoja. Ma mbylli gojën me një të puthur, më kapì për dore dhe më drejtoi në dush.

Bëmë dashuri me nxitim nën ujën e freskët të dushit. Ishte kaq i eksituar. Sikur donte të më bënte që ta falja për nxitimin e tij, të më tregonte se vleja shumë për të. U ndjeva e dëshiruar, e mrekullueshme. Ashtu si ndihen të gjitha gratë kur një burrë shkrihet për hatër të tyre. E shijova me të vërtetë atë moment pasioni të shfrenuar.

Nuk më la të merrja taksi. Më çoi vetë në aeroportin e Kosë, dhe nuk reshti së puthuri gjithë pasion, dhe të më përkëdhelte me dashuri, derisa njoftuan për fluturimin.

- Jason, mos bëj kështu. Nuk do të iki përgjithmonë. Do të më shohësh përsëri, më beso. Ajo që dua prej teje është të më urosh sukses në intervistë. Dhe ta dish se së shpejti do të jem pranë teje, - i thashë.

- Stela ime, vogëlushja ime, nuk dua të të humbas, - më pëshpëriti dhe më përkëdheli përsëri.

- Po ç'të gjeti kaq papritur? Ç'janë këto që thua? Nuk... do të më humbasësh, - iu përgjigja e çuditur.

- Nuk dua të të humbas dhe nuk do të të humbas kurrë! - bërtiti, duke i theksuar fjalët një e nga një, në momentin që po largohesha prej tij.

Fjalët e tij të fundit vërtiteshin akoma në kokën time kur u ula në avion.

Duhej të gëzohesha me këto fjalë.

Apo jo?

Po përse jehonin brenda meje si kërcënuese?

Është e tmerrshme të të shkatërrojnë ato ditë të pakta të pushimeve, të të detyrojnë të kthehesh në mes të gushtit në Athinë, në një qytet të shkretë, që të bën të mendosh se të gjithë banorët e saj e kanë braktisur dhe gjenden në ndonjë breg duke u çlodhur nën rrezet e diellit.

Dashje pa dashje, bëhesh xheloze.

Por kisha një qëllim që duhej ta realizoja me sukses. Kthimi në kryeqytet ishte i rëndësishëm për mua. Megjithatë, ndihesha çuditshëm në darkë në shtëpinë time.

Shumë qetësi, shumë vetmi, shumë vapë.

Kisha kohë të mbetesh vetëm, kërkoja Jasonin dhe kjo më bënte të kuptoja se pak e nga pak po bëhej pjesë e imja. Pasi pastrova pak shtëpinë dhe bëra një dush, nuk durova dot më. E mora në celular.

- Po rri shtrirë në krevatin tonë, pikërisht si më propozove ti, zemra ime, dhe mendoj për ty, - më tha

dhe iu hap goja, duke më bërë edhe një herë tjetër atë ditë që të ndieja brejtje ndërgegjeje.

- Mbaje të nxehtë derisa të kthehem, - i përgjigja me sa më shumë entuziazëm që munda.

- A e di se çfarë do të bëj nesër në mëngjes derisa të kthehesh përsëri pranë meje? - belbëzoi.

- E di. Do të shijosh mëngjesin tënd, se unë nuk të lë ta shijosh, - i thashë duke qeshur.

- Jo. Nuk jam aq egoist sa beson ti. Do të kërkoj të gjej ndonjë cep të ishullit që nuk e kam zbuluar deri tani, vogëlushja ime, që të surprizoj. Që të të bëj të çmendesh nga gëzimi, - m'u përgjigj.

Fjalët e tij ishin me të vërtetë surprizë për mua. Nuk e dija nëse thoshte të vërtetën, nëse do të përpiquej të gjente një vend të ri që të më bënte të gëzohesha. Por ishte hera e parë, të paktën, që mendoj diçka për hatrin tim. Natyrisht, përveç propozimit për martesë, që më kishte pështjelluar kaq shumë. Një herë mendoja pozitivisht dhe një herë negativisht.

Hera e parë që ishte interesuar me të vërtetë për nevojat e mia.

Kisha filluar, dalëngadalë, të kuptoja se isha me të vërtetë vajza që ai dashuronte. Dhe nuk mund të them që nuk më pëlqente.

Ndoshta e kisha fajin unë që mendoja mbrapsht për Jasonin.

Ndoshta e kishte fajin karakteri im i pavarur. Mund të kisha frikë të lidhesha me dikë. Ndoshta, pa dashje, po përpiquesha ta nxirrja të pavlefshëm. Që të mos më

mohonte lirinë time. Po, kisha nevojë për një lidhje, por ajo shprehja “përgjithmonë bashkë”, me trembte.

Nuk nguroj të pranoj që kam lexuar shumë libra psikologjikë. Biblioteka ime është plot. Në një moment ndala papritur të merresha me to. Sepse kuptova se dëshpërimisht kërkoja të gjeja se çfarë fshihnin njerëzit pas fjalëve të tyre. M’u bë shprehi t’i klasifikoj të gjithë në kategori dhe të mërzhitem për gjënë më të vogël. Kisha pësuar një si psikozë me Frojdin, Jungun, Kleinin, Fromin. Por nëse nuk e ke studiuar subjektin, pështjellohesh. Dhe të gjitha bëhen lëmsh brenda teje.

- Të falënderoj, Jason. Më pëlqeu shumë kjo që më the dhe, po, do të doja të gjeje një vend të ri në Ko për hatrin tim, - iu përgjigja.

Dhe e kisha me të vërtetë.

U entuziazmuva. Derisa të më zinte gjumi, e stërlodhur nga udhëtimi, më dërgoi dhjetëra mesazhe në celular. “Më mungon”, shkruante. “Të dua. U mërzhita vetëm. Çfarë do të dëshiroje të të bëja tani?”, e shumë të tilla.

Iu përgjigja. Të gjithave.

Kur më shkroi mesazhin e fundit, nuk durova dot më, dhe i shkrova:

- Të më uroje që t’ia dal sa më mirë mbanë me intervistën nesër, natyrisht. Është shumë e rëndësishme për mua.

Edhe një herë tjetër, brenda mendjes sime filloi të më ulërinte ai zë i çuditshëm, që mendonte vetëm për

veten dhe rehatinë e vet. Psherëtiva dhe u përpoqa të mos mendoja më.

Fika dritën.

U zgjova pa gdhirë mirë. Puna e parë që duhej të bëja ishte të rregulloja flokët e mi të fryrë, që kohët e fundit i kisha prerë mjaft shkurt. Doja që në intervistë të paraqitesha si një ekonomiste e denjë, që dëshiron të punojë në bankë. Kripa e detit dhe dielli kishin egërsuar kaçurrelat e mi. Por ia dola t'i bindja. Bëra makijazh të lehtë, veshja një kostum të ri, e bëra në këmbë rrugën deri në Kifisias dhe aty hipa në autobus. Banka ndodhej në krye të bulevardit "Aleksandras", në lagjen "Ambelokipi".

Kur mbërrita, dridhesha e tëra nga ankthi. Mora frymë thellë, u përpoqa të gjej vetëkontrollin dhe hyra brenda.

Intervista nuk zgjati shumë, zotëria që m'u prezantua si drejtor i personelit, ishte i sjellshëm dhe pamja e tij shprehte mirësi. Pyetjet e tij qenë të zakonshme. U entuziazmua nga rezultatet e studimeve dhe nga studimet pasuniversitare që kisha kryer. Isha një ndër studentet që kisha mbaruar me rezultate mjaft të mira Fakultetin Ekonomik dhe kisha përfunduar me sukses masterin për bursë në një universitet me emër të Anglisë. Pak para se të largohesha, më shpjegoi se do të intervistonte dhe kandidatë të tjerë dhe do të më njoftonte sa më shpejt të mundej.

Kur dola nga banka, i telefonova agjentit që njoha në Ko. Për fat të keq më zhgënjeu.

- Nëse nxitoni, do t'ju këshilloja të shkoni në aeroport dhe të prisni. Jeni e para në listën e pritjes për fluturimin e sotëm. Përndryshe, ju njoftojmë se ka një vend të lirë, por pas dy ditësh. T'jua rezervoj?  
- më pyeti.

- Jo, duhet të kthehem në ishull sa më shpejt të jetë e mundur, - iu përgjigja.

Vendosa të kthehesha me traget. Do të shkoja në Pire me tren dhe do t'i hipja tragetit të parë që nisej drejt ishujve të Dodekanisë. Të nesërmen në mëngjes do të gjendesha përsëri në Ko. Edhe nëse nuk do të kishte kabinë të lirë, do ta kaloja natën në kuvertë. Do të sodisja yjet, do të merrja ajër deti. Ia vlente të torturohesha pak për punën që shpresoja të filloja.

Sapo u ktheva në shtëpi, i telefonova Jasonit. Kur i shpjegova situatën, u tërbua.

- Jam idiote! E kam me të vërtetë. Sepse besoja që do të gëzohesha që ia dola mirë me intervistën, - i bërtita e mërzitur. - Nuk do të jem pranë teje sot pasdite, por nesër në mëngjes. Nuk është ndonjë gjë e madhe. Prisja të më kuptoje. Nuk ia ke idenë se çfarë do të thotë të jesh pa punë, nuk e di. Dhe ti nuk më urove as një "të vaftë mbarë". E vetmja gjë që të interesoi, e vetmja gjë që të intereson, është vetja jote.

- Nuk duhej të të kisha lënë të shkoje, - më tha vrazhdë dhe më mbylli telefonin.

Fjalët e tij më bënë ta humbisja toruan.

Nuk duhej të më kishte lënë të ikja? Si guxoi të më thoshte diçka të tillë? E çfarë nënkuptonte? Mos bënte shaka?

I gjithë gëzimi i ditës së sotme u zhduk menjëherë. Kush ishte ai në fund të fundit, që më fliste në këtë mënyrë? Sërish po më shqetësonte. Nuk e dija nëse duhej ta shaja apo t'i pëshpëritja fjalë të ëmbla. Mendonte se do ta pyesja? Se më parë do të merrja lejen e tij? Isha e burgosura e tij? Po hiqej si diktator? Mos do të ishte më mirë për mua të mos kthehesha në Ko dhe ta harroja njëherë e përgjithmonë? Pse sillej kështu me mua? E çfarë duhej të bëja?

Në momentin që brenda meje përlesheshin një sërë ndjenjash kontradiktore, ra zilja e celularit. Isha e sigurt që ishte Jasoni. Jasoni që më mërzi me fjalët e tij, i gatshëm për të më kërkuar falje, i gatshëm për të më shpjeguar se kishte bërë shaka.

Por nuk ishte ai. Ishte agjenti.

- Zonja Damianu, ç'të të them? Jeni me shumë fat, - më tha. - Sapo u anulua një biletë dhe përderisa ishit e para në listën e pritjes, ju takon juve. Do të niseni për Ko pas dy orësh.

E falënderova dhe mbylla telefonin. Kisha kohë vetëm për të vajtur deri në aeroport.

Por, a doja të shkoja?

U zhvesha dhe bëra shpejt e shpejt një dush që të vija në vete. Pse dreqin isha kaq e ndjeshme? Pse mërziutesha për gjënë më të vogël? Me siguri që Jasoni nuk i nënkuptonte të gjitha ato që më kishte thënë. Nuk duhej të mërziutesha me të sa herë që ai thoshte gjëra që më dukeshin të çuditshme. Pse nuk e lija



veten time të lirë të shijonte pasionin, këtë lidhje? Pse i bëja analizë gjithçkaje?

Duhej, e kisha shumë të nevojshme të qetësohesha.

Vesha xhinset dhe një këmishë, rrëmbeva valixhen time të vogël, mora taksinë e parë që më doli përpara dhe u nisa për në aeroport.

Gjatë rrugës për në aeroportin “Eleftherios Venizelos” u mata disa herë ta merrja Jasonin në telefon, e t’i thosha lajmin e mirë. Bëhesha gati të formoja numrin, pastaj pendohesha.

Në fund vendosa t’i bëja edhe unë një surprizë, si ajo që më kishte premtuar ai.

Do të futesha në dhomën tonë të hotelit, kur ai nuk më priste. Do ta bëja të shkëlqente nga gëzimi. Mezi po prisja. Pas pak do të zhytesha në ujërat e ishullit që dashuroja, në krahët e burrit që...

Ishte shumë herë për të folur rreth ndjenjave të mia për të, por shpejt, shumë shpejt, çdo gjë brenda meje do të qartësohej. Por, gjithsesi, isha me shumë fat, siç më kishte thënë dhe agjenti. Jo për biletën, sigurisht. Por sepse ia kisha dalë mirë me intervistën dhe kisha një burrë që më dashuronte dhe më priste në një ishull të mrekullueshëm, për të shijuar së bashku ato ditë pushimesh.

Mora frymë thellë dhe vështrova jashtë. Rrugët ishin pothuajse të shkreta. Taksia rendte me shpejtësi. Nuk e pengonin radhët e zakonshme të makinave. Madje edhe taksixhiu ishte në humor. Këndonte me zë të ulët një këngë të Mihali Haxijanit: “Nëse je det,

unë të përqafova. Dhe nëse je erë, unë të shtrëngova. Dhe nëse e nesërmja është në dorën time, do të jesh gjithmonë stina e verës për mua...”

Pa e kuptuar fillova ta këndoja edhe unë. Mbërrita në aeroport pothuajse pa e kuptuar. Përfundimisht është bukur të jesh në Athinë në muajin gusht. I mbaron punët shpejt, lëviz pa mbetur në trafik, e dashuron me të vërtetë kryeqytetin.

Dola nga taksia, u futa në sallën e nisjeve dhe mora drejtimin për në platformë. Kur mora në dorë biletën e udhëtimit, më dukej sikur më kishin bërë ndonjë dhuratë.

Udhëtimi ishte i mrekullueshëm, pa boshllëqe në ajër, fluturonim shumë ulët. Rrija pranë dritares.

E kisha ngjitur fytyrën te xhami dhe admiroja ishujt poshtë meje. Dukeshin si pikturë. Deti i pamatë, i thellë, i kaltër. E çanin tek-tuk tragete të linjës, që linin pas tyre një monopat të bardhë.

Kur avioni u ul në Ko dhe fillova të zbres shkallët, më përmbytën aromat e mia të dashura. Lagështia e detit përzier me lule akonizë (*disttrichia viscosa*) dhe trumzë, si dhe bimë të tjera që mbijnë në kodrat me rërë të ishullit. E adhuroja këtë aromë të këndshme, që ishte kaq e ndryshme nga ajri i ndotur i kryeqytetit. Nga padurimi bëja ecejake në sallën e aeroportit, duke pritur valixhen, së bashku me shumë turistë. Anglezë, holandezë, francezë, gjermanë. Ishulli Ko është shumë i dashur për europianët.

Në një moment e rrëmbeva dhe nxitova të merrja një taksì. Nga aeroporti duhej pothuajse gjysmë ore

deri në qendër të qytetit të Kosë. Psalidi, vendi ku ishte hoteli, është një prej vendeve më të bukura të qytetit, i mbushur me hotele bashkëkohore, me taverna buzë detit, minimarket, fusha minigolfi, madje kishte dhe habitat për zogjtë e egër. Gjatë rrugës mendova t'i propozoja Jasonit të shkonim edhe në një shëtitje të habitatit ujor ose për ndonjë gotë uzo në Zia, në fshatin verior me atë pamje të mrekullueshme.

Imagjinoja sesi do të reagonte kur të më shihte papritur përpara vetes. Do të hapte krahët dhe unë do të strukesha aty dhe do ta ledhatoja dhe... a do të më linte vallë të bëja një dush, apo do të kishte gjëra të tjera në mendje?

Buzëqesha me padurim, si një fëmijë që përgatitej të hapte dhuratat që i kishin sjellë. Mendoja se më në fund mund edhe të mposhtja çdo kundërshtim timin dhe ta pranoja unazën e tij.

Ndoshta pas pak orësh ajo unazë me topaz do të zbukuronte gishtin tim, për të treguar, natyrisht, se isha e dashura e tij, dhe jo gruaja e tij e ardhshme.

Çdo gjë në kohën e duhur.

Po buzëqeshja edhe kur pagova taksixhiun dhe nxitova me valixhen në dorë drejt hotelit. Shtypa butonin e ashensorit për në katin e parë, dhe vrapova në korridorin ku ndodhej dhoma jonë.

Vendosa çelësin në bravë dhe hapa derën. Isha e gatshme të bëja gjithçka që kisha ëndërruar sapo të bija në krahët e Jasonit.

- Surprizë! - pothuajse ulërita nga gëzimi.

Dhe lashë valixhen në dysHEME.

Dhe në atë moment mbeta pa frymë. Ngriva.

Sepse ishte me të vërtetë surprizë. Pikërisht ashtu siç e imagjinoja. Por jo vetëm për Jasonin. Por edhe për mua.

Në krevatin dopjo, në atë krevat ku mbrëmë në darkë Jasoni më kishte thënë se e ngrohte për hatrin tim, gjendej një grua. Një grua dymetroshe. E huaj, mesa munda të kuptoj në ato pak sekonda që e pashë.

Një grua e zhveshur lakuriq.

Pranë saj, me njërën këmbë të mbështetur mbi trupin e saj të hollë, gjendej i shtrirë Jasoni.

Ishte lakuriq edhe ai.

E humbi toruan. U ngrit ndenjurr.

- Stela? - bërtiti.

Zëri i tij më riktheu në realitet. Rrëmbeva valixhen dhe fillova të vrapoj. Në korridor u pengova te karroca e një prej kamerierëve dhe rashë përtokë. Kur po përpiquesha të ngrihesha, e pashë të përkulej mbi mua.

Kishte mbështjellë rreth mesit shpejt e shpejt një peshqir.

Një makth i vërtetë.

Më zgjati dorën që të më ndihmonte të ngrihesha.

- Mos guxo të më prekësh! - ulërita me aq forcë, sa u tremba edhe vetë.

- Dëgjo, më fal, nuk kuptove... Unë... domethënë ajo grua... m'u ngjit... - pëshpëriti.

- Çfarë? Çfarë janë këto që thua? - bërtita.

- Hajde tani, zemra ime, mos bëj kështu. Për mua nuk ishte asgjë. Vetëm një kontakt fizik ishte. Kaq rëndësi ka? Tani që u kthye vogëlushja ime? Tani që e kam pranë? Plotësisht timen.

Edhe kësaj here nuk mund të besoja ato që po dëgjoja. Dridhësia e tëra. U ngrita në këmbë me të gjithë dinjitetin që munda të gjej te vetja ime.

- Lidhja jonë mori fund! - i thashë e vendosur.

Dhe këtë herë nuk bërtita. Vetëm e vështrova në sy. Sytë e tij shkëlqenin të egërsuar. Brenda dallohej një si tërbim që më trembi.

- Duhet të më falësh. Ishte vetëm një budallallëk i momentit. Të thashë që vetë m'u ngjit, - vazhdoi të njëjtin avaz Jasoni.

- Nuk më intereson, - pëshpërita.

Nuk isha në gjendje që të vazhdoja ta vështroja.

Ula sytë. Isha gati t'ia mbathja vrapit, të zhdukësia, të mos e shihja më para syve atë njeri. Papritur mendova se nuk isha unë ajo që duhej të ikte.

- Thuaji gruas që t'u ngjit të zhduket menjëherë, - i thashë.

Në mënyrën më të ftohtë dhe më gjakftohtë që mundesha.

- Kështu po, zemra ime. Tani po flet ashtu si duhet. Dhe kjo që dëshiron do të bëhet për një minutë, - më tha dhe u bë gati të largohej prej meje.

- Dëgjo, - i thirra. - Bashkë me të do të zhdukesh edhe ti. Do të pres në recepsion të më boshatisni dhomën sa më shpejt të jetë e mundur. Dua të vazhdoj

e qetë pushimet e mia, - plotësova dhe e vështrova pa marrë parasysh rrezikun.

E humbi toruan. U ndal dhe më vështroi. Isha e sigurt se po përpiqej të mendohej se ç' duhej të bënte, ç' duhej të më thoshte. Por edhe unë e kisha humbur toruan me reagimin tim.

Me të vërtetë, ku e kisha gjetur gjithë atë forcë? Zakonisht i lë situatat që të bëjnë ç'të duan me mua. Dhe pas njëfarë kohe gjej mënyrën, mënyrën se si duhej të kisha reaguar. Fjalët e duhura që duhet të thosha.

E përgëzova veten time në heshtje. Sepse kisha plotësisht të drejtë. Pse të kthehesha përsëri në Athinë? Përse të mos vazhdoja pushimet e mia?

- Nuk e di se ç'po ndodh me ty! Nuk di se ç'thua! - më tha papritur Jasoni, kur ia doli më në fund të fliste. - Shko poshtë dhe pi një kafe. Një kafe të fortë. Do të të bëjë mirë. Do të qetësohesh, - vazhdoi.

E ngula vështrimin te sytë e tij ngjyrë mjalti në formë bajameje. Dhe për herë të parë, që në momentin kur e njoha, zbulova se sytë e tij kishin diçka... diçka që më trembte.

Por e vendosa.

Në buzët e mia u pikturua një buzëqeshje e lehtë.

- Dëgjo, po të kërkoj falje përsëri. Ti nuk ishe... dhe... Ishte një budallallëk i momentit, zemra ime. Vetëm një kontakt fizik ishte, po ta përsëris. Përse nuk mund ta kapërdish? - vazhdoi duke besuar se do të më bindte.

O Zot! Ç'ishin këto që thoshte? Ç'donte të thoshte? Se ngaqë nuk isha unë, prandaj u detyrua të shkonte me një grua çfarëdo që i doli përpara? Si ishte e mundur që ta falja?

Më kishte tradhtuar. Si mund t'i besoja përsëri? Në atë moment u ndërjegjësova, se nuk do të thoshte asgjë për mua.

Nuk e dashuroja. Nuk e doja.

E kisha humbur toruan që e gjeta në krevat me një grua tjetër. Por nuk më kishte shkaktuar dhimbje. Nuk kisha ndier asgjë. Vetëm lehtësim, që do të shpëtoja prej tij. Kaq lehtë.

Buzëqesha përsëri.

- Isha vetëm, pa vogëlushen time që e adhuroj, dhe erdhi më kërkoi t'i ndizja cigaren. E kupton se si bëhen këto gjëra. Në fillim nuk i kushtova rëndësi. E kam me të vërtetë. Por ajo këmbënguli. Ju gratë tërbohemi kur një burrë nuk iu kushton vëmendje! Në fund mendova, pse jo? Çfarë kam për të humbur? Vetëm një trup ishte. Vetëm një trup me të cilin bëja ç'të doja në krevat. Ndërsa ty, ty zemra ime, të dashuroj. E di këtë, apo jo? Dhe jam i sigurt që më dashuron edhe ti, por nuk do ta pranosh akoma.

Thoshte çfarëdo lloj budallallëku që i vinte në mendje. Dhe dukej tepër qesharak me peshqirin e lidhur në mes.

Papritur ia plasa gazit.

- Je shumë i lezetshëm, Jason, që të mos them ndonjë gjë më shumë, - e ndërpreva.

Buzëqeshi mekanikisht dhe u përpoq të më përqafoje. Ndjeva kaq neveri, saqë e shtyva me gjithë forcën. Edhe nga mendimi se mund të më prekte më vinte ndot.

- Mbaruam, djalosh. E kuptova apo do të ta përsëris? Mbaruam. Përgjithmonë. Lidhja jonë, çfarëdo që të ishte, mori fund. Nuk dua të të shoh më. Që në këtë moment nuk jemi më të lidhur, - i thashë.

- Mos thuaj fjalë për të cilat do të pendohesh më vonë, - më tha.

Me paturpësi.

- Je i çmendur. Krejt i çmendur, - fillova përsëri të bërtisja. - Për hekura je! Tani ik e merre atë nga krevati sa më shpejt të mundesh.

- Nuk di se çfarë thua. Po flet përçart, - bërtiti dhe ai.

- E di se çfarë them, dhe shumë mirë, madje. Dhe do të doja të të falënderoja që më tregove kaq shpejt dhe kaq qartë karakterin tënd. Dakord? Hajde, shkofsh në djall tani e, madje, edhe më tej! - u çora unë. Dhe pastaj i ktheva shpinën dhe zbrita përsëri te recepsioni. Ishte e çuditshme, por dridhesha e tëra. Isha tmerrësisht e inatosur me veten time. Por nuk ia vlente të tensionohesha për një njeri si Jasoni. U afrova te bari dhe porosita një uiski. Për t'u qetësuar.

Isha e sigurt se kisha marrë vendimin e duhur. Nuk isha unë ajo që duhej të zhdukej nga ishulli. Do të përpiquesha të vazhdoja pushimet e mia. Dhe do të



kërkoja të më ndërronin dhomë, natyrisht. Nuk duroja dot të shtrihesha tek ai krevat dopjo ku...

Hodha një vështrim jashtë, nga vetratat e mëdha të barit. Drita e diellit, që reflektonte në det, dukej sikur dridhej nga valëzimi i tij, klientë të hotelit hynin e dilnin në verandat e mëdha, fëmijë thërrisnin të gëzuar në pishinë mbi rosakë plastikë shumëngjyrësh dhe peshkaqenë plastikë sterrë të zinj.

Jeta vazhdonte. Pa i interesuar aspak nëse më kishte tradhtuar Jasoni.

Buzëqesha me ironi dhe piva një gllënjë nga pija. Uiski më dogji fytyrën. Por nuk më bënte përshtypje. Sepse pengonte lotët që ishin gati të rridhnin nga sytë e mi.

Piva një gllënjë tjetër dhe atëherë nuk durova dot më. Fillova të qaj.

Jo, jo për Jasonin.

Lotët e mi ishin lot poshtërimi. Ndieja, që me sjelljen e tij, më kishte poshtëruar, më kishte tradhtuar. Por nuk kisha arritur ta dashuroja. Nuk kisha arritur t'i falja zemrën. Isha me fat. Mund të zgjidhte kë trup të donte për në krevatin e tij. Madje mund të bënte seks me të gjitha turistet e ishullit.

Nuk më interesonte. Aspak.

Pse i thosha gënjeshtra vetë vetes sime? Më interesonte. Dhe shumë madje. Ndiehesha keq. Këtë që kisha kaluar sot e kisha lexuar në shumë libra. Dhe ndieja me të vërtetë dhembshuri për personazhet e tradhtuara. Zakonisht janë gratë ato që kalojnë situata të tilla nëpër romane. Por edhe në jetë. Përse vallë?

I fshiva lotët me duar. Piva edhe një gllënjکہ uiski.

Sigurisht që në këtë situatë të papëlqyer nuk gjenden vetëm gratë. Edhe ato tradhtojnë. Por dinë të fshihen më mirë. Një grua ka mundësinë të bëjë seks me të dashurin në një dhomë tjetër, në një krevat tjetër, dhe jo tek ai që ndan me shokun e saj.

Përfundimisht, kisha filluar të mendoja budallallëqe. Tradhtia nuk kishte lidhej me gjininë, por me personalitetin e çdo njeriu. Me vlerat dhe besimin e tij.

Isha pa ngrënë dhe uiski kishte filluar të më ngacmonte.

Nëse do të më shihte nëna ime duke pirë vetëm në barin e ndonjë hoteli duke qarë për fatin tim, nuk do të hezitonte aspak të më thoshte: “Koka bën, koka pëson. Nuk ndenje në Kalimno, nuk të pëlqeu ta kaloje jetën në një ishull në kufi. Doje të hapje krahët. Por do të ishte e lumtur këtu pranë nesh. Do të të gjenim një djalë të mirë nga ishulli, dhe do të ndërtonit një familje të lumtur”.

Do të më thoshte dhe të tjera. Tashmë, gjëra të njohura. I përkiste një kohe tjetër. Gratë, sipas mendimit të saj, duhej të kujdeseshin vetëm për familjen e tyre.

“Një nikoqire e mirë është shërbëtore dhe zonjë, nuk vazhdon studimet, nuk shkon andej-këtej, nuk e lë mendjen t i marrë erë”, më thoshte zakonisht.

Ishte kaq e vështirë t’ia dilja të merresha vesh me të.

Sa për babanë, isha plotësisht e sigurt se do të përpiqej të bënte ç’ ishte e mundur që të ndihesh më

mirë. Që ta kaloja sa më shpejt këtë zhgënjim. Ishte i dashur, i ndjeshëm. Më kuptonte plotësisht. Ishte krenar që kishte vajza, besonte te të drejtat e gruas.

Sa mirë që erdhëm në Ko për pushime dhe nuk menduam të shkonim në Kalimno që ta njihja Jasonin me familjen time.

“Përfundimisht jam me fat”, thashë me vete dhe buzëqesha me ironi.

Tashmë kisha filluar të shihja turbull nga pija. Por ia dola të dalloja siluetën e Jasonit. Po ikte nga hoteli së bashku me valixhet e tij.

- Udhë të mbarë, e mos harro të na shkruash! - bërtita duke ngritur gotën me pije.

Pastaj u ktheva që të shihja më mirë derën dykanatëshe prej xhami të hotelit që u hap e u mbyll.

Dhe mbylli mbrapa saj një kapitull të vogël, por të hidhur të jetës sime.

## Jasoni

**T**a marrë dreqi, ta marrë, pse duhej të kthehej më herët? Ç'janë dhe këto gratë! Shfaqen aty ku nuk i pret. Sa shumë iu luta që të mos më linte fillikat, të mos kthehej në Athinë në mes të vapës. Dhe ajo, në vend që të më falënderonte që mendova për të, çfarë bëri? Më flaku nga jeta e saj.

Mosmirënjohëse.

E kush ishte gabimi im? Se bëra seks me një grua tjetër. Burrat gjithë kohën bëjnë gjëra të tilla. Të gjithë burrat e planetit. Nuk bëra ndonjë gjë të keqe. Pse vallë reagojnë kështu gratë, sikur nuk kuptojnë, pse sillen si fëmijë të papjekur? Shkatërrojnë marrëdhënie, familje, vetëm e vetëm se bëhen xhelozë që na shohin me ndonjë tjetër në krevat. Por nuk më vjen keq. Aspak. Stela nuk di një gjë shumë të rëndësishme. Por veçse shumë shpejt do ta marrë vesh.

Se nuk do të mund të shpëtojë prej meje.

Kurrë!

Çfarëdo që të bëjë, çfarëdo që të sajorë, unë do të jem aty, para saj. Që në momentin e parë që e pashë tek ai panair i librit, kuptova se është vajza e ëndrrave të mia. Do apo nuk do. Kur zgjedh një grua, askush nuk mund të më kundërshtojë. Pengesat më pëlqejnë, më japin forcë. Më bëjnë të sajorë një mijë e një zgjidhje për t'i kapërcyer.

Por rrija në një kafene të ishullit dhe po pyesja veten se ç' duhej të bëja. Të kthehesha në hotel duke mbajtur në duar një buqetë me lule të shtrenjta? Veprime të tilla i tërbojnë gratë. Por përtoja të shkoja e të gjeja ndonjë dyqan lulesh. Bënte shumë vapë. Mos duhej t'i ulesha në gjunjë e t'i kërkoja falje?

Jo, jo. Nuk ishte aspak ide e mirë.

Do të nxehej e do të më zbonte përsëri.

Ishte bërë egërsirë, se më kishte zënë me presh në duar, me atë turisten dymetroshe. E paimagjinueshme se sa shumë u lëndua. A thua se bëra ndonjë veprim të neveritshëm. U soll me mua sikur të isha kriminel. Sikur i kisha vrarë babanë. E pak po them. Nëse do t'u tregoja shokëve të mi se çfarë më kishte ndodhur, nuk do të më besonin.

Do të talleshin me mua.

- Koka bën, koka pëson. Ç'të gjeti? Pse i shkon mbrapa si qen asaj thananikes? - do të më thoshin.

Sepse është e pamundur të kuptojnë se Stela përfaqëson pikërisht atë çka unë dëshiroj te një grua.

Nuk është mace, por tigër. Dhe nga më të egrat, madje. Ka një karakter të pavarur, të panënshtuar, dhe është e gjatë, dhe e dobët. Një trup me forma të përkryera, ashtu siç i pëlqejnë çdo mashkulli.

Më tërbon fare.

Kur egërsohet, transformohet në perëndi. Sytë e saj jeshilë shkëlqejnë, lëshojnë xixa. Flokët e saj të zinj, të prerë shkurt, ngrihen përpjetë. Si një iriq i vogël i inatosur bëhet. Të kujton një vajzë çapkëne si djalë, që e qortojnë dhe dëshpërimisht kërkon të gjejë të drejtën e vet. Nuk them, e bukur ishte edhe ajo turistja bionde e nxirë nga dielli, që njoha në plazh. Ngjante me një manekin. Kishte këmbë të gjata, të bukura, dhe gjoks të madh. Ishte e duhura për atë punë që më duhej mua.

Po përse nuk e kuptojnë gratë se burrat i ndajnë ato në dy kategori? Në ato që destinohen për martesë dhe në ato kandidatë që janë për marrëdhënie rastësore seksuale. Madje, janë bërë dhe kërkime të universiteteve me emër për këtë temë. Kaq e vështirë është pra? Mendoj se duhet ta mësojnë nëpër shkolla, ta mësojmë të gjithë që herët, që të mos lindin keqkuptime të tilla.

Piva edhe një gllënjë tjetër nga kapuçinoja dhe e lashë vështrimin të endet në ishullin që i pëlqente kaq shumë vogëlushes sime. Por kishte të drejtë. Është shumë i bukur. Me një vështrim të vetëm mund të dallosh kolona antike, minare dhe as vetë s'e di se çfarë tjetër. Dhe më e rëndësishmja? Vajza të bukura

nga çdo skaj i botës. Vajza të gatshme për çdo lloj çmendurie.

Papritur m'u kujtua turistja dhe fillova të dridhesha përsëri nga inati. Në të vërtetë, Stela është shumë mosmirënjohëse. I plotësova dëshirën, dhe gjeta belanë. Unë preferoja të shkonim me pushim në Mikonos. Ajo këmbënguli të vinim në Ko. Dhe ja ku përfundam.

Por nëse Stela do e dinte se çfarë e priste që sot e tutje, nuk do të sillej me mua në atë mënyrë.

As për shaka.

Fillova të qeshja me vete. Me keqdashje. Kamerieri i ri në moshë, që vinte rrotull tavolinave, më hodhi një vështrim të çuditshëm. Isha gati ta thërrisja të vinte pranë meje e të filloja t'i përshkruaja gafën time të sotme, kur më ndalën disa zëra afër meje.

“Kaluan shumë bukur, po të them”, çirrej një mesogrua te tavolina ngjitur. “Ma tha Jolanda. Dhe ti e di mirë, se ato që thotë ajo duhen marrë në konsideratë. Hipën në një anije të vogël këtu te porti i vjetër, dhe bënë një ekskursion njëditor në Kalimno. Shëtitën nëpër qytet, vizituan kishën, që e quajnë... A, po. Katedralja Metropolitane e Shpërftyrimit të Shpëtimtarit Jezu Krisht.” Mikja ime e kishte vendosur të shkonte të admironte ikonostasin e saj.

Kjo mesogrua fliste shumë shpejt me një ton imponues. Zëri i saj çjerrës ishte kaq i mprehtë, sa më bëri të rrëqethem.

Më erdhi keq për burrin që rrinte përkrah saj.

Nëse nuk do të më interesonin ato që thoshte, me siguri do të kisha mbyllur veshët në mënyrë demonstrative me duar. Ishte nevojë absolute ta pengonin që të shfaqej në ambiente publike.

“Përderisa Kalimnos është kaq afër, pse nuk shkojmë dhe ne ta vizitojmë?”, guxoi ta ndërpriste në një moment i shkreti burrë, që gjendej pranë saj.

“Të shkojmë, pse të mos shkojmë? Të lutemi dhe ne në kishë, të blejmë dhe sfungjerë deti. Për nënën time. Është e fiksuar pas tyre”, u përgjigj gruaja e tij.

“Nëse i pëlqejnë kaq shumë, nuk do të hezitoj aspak. Do të zhytem edhe unë së bashku me gjuetarët vendas të sfungjerëve, për hatër të vjehrrës sime”, belbëzoi burri me një nuancë ironie në zërin e tij.

Dhe pastaj, për të qenë brenda, uli kokën i frikësuar.

Kisha filluar të ndieja me të vërtetë keqardhje për të, kur papritur më kaloi nëpër mend që Kalimno ishte ishulli në të cilin banonin prindërit e Stelës.

E mora menjëherë vendimin tim.

Nuk do të kthehesha në Athinë. Kisha edhe pesë ditë në dispozicion. Do të shkoja në Kalimno. Afër vjehrrës dhe vjehrrit tim të ardhshëm.

U ndjeva menjëherë më mirë.

Ideja ime ishte diçka më shumë se e përkryer. Stela nuk donte akoma që të më njihje me prindërit e saj. Por nuk ishte problem. Do të njihesha vetë me ta.

Pagova kafënë, u ngrita në këmbë, dhe u ndala për një moment. Nxora nga xhepi celularin. Doja t’i telefonoja Stelës. Ndoshta edhe mund të ishte penduar



që u soll aq keq me mua. Mund edhe të më thoshte që të kthehesha sa më shpejt që të ishte e mundur pranë saj.

- Zemër, - i thashë sa më ëmbël që mundesha, kur dëgjova zërin e saj. - Ç'po bën? Je ende e zemëruar me mua?

- Jason! - bërtiti e habitur.

Diçka në intonacionin e zërit të saj nuk më pëlqeu. Sikur ishte e dehur. E dehur? Natyrisht. Përse pyesja veten për diçka të tillë? Iu dha pijes sapo e braktisa. U pendua që më zboi dhe filloi ta mbyste pikëllimin me alkool. U entuziazmovava.

- Vogëlushja ime, e shtrenjta ime. Të ranë nervat? Dëshiron të kthehet i dashuri yt? Të të marrë në krahë dhe të të bëjë të lumtur? - i pëshpërita.

- Si guxove të më telefonoje? Si guxove? - u çor ajo gjithë egërsi.

Tigresha ime. Tigresha ime e egërsuar ishte ngjallur edhe për një herë tjetër.

- Po vij, e dashur, po vij, - thirra i gëzuar.

Dhe në atë moment më tha diçka që më bëri ta humbas toruan.

- Mos guxo të më marrësh përsëri në telefon, dëgjon? Mos guxo se nuk do të ta ngre më.

- Nuk di se ç'thua. Dhe është mëkat të... - iu përgjigja i pikëlluar.

Më ndërpreu papritur. Dhe gjithë nerva.

- E di shumë mirë se çfarë them. Lidhja jonë mori fund. Përgjithmonë. Nuk dua të të shoh më kurrë në

jetën time. Nuk dua të flas kurrë më me ty. Nuk dua të dëgjoj më për ty.

- Stela, - belbëzova.

- Lamtumirë! Përgjithmonë, - ulëriti përsëri dhe mbylli telefonin.

Por kot e kishte.

Vendosa celularin në xhep. Isha i zhgënjyer. Me sa kisha kuptuar, do të vononte t'i binte inati. Diçka duhej të bëja. Që të isha i përgatitur.

Mund të mos donte të më kishte pranë, por nuk mund të më flakte nga jeta e saj. Vetëm nëse vendosja vetë për këtë. Besonte se nuk do të më shihte më. Por bënte gabim të madh.

Edhe do të më shihte, edhe do të më fliste.

Nuk mund të më flakte në plehra. Në asnjë mënyrë.

Mora frymë thellë dhe u nisa drejt portit. Tashmë e kisha dorëzuar makinën që kishim marrë me qira. Ecja duke tërhequr valixhen, që bënte një zhurmë të çuditshme. Një si klithmë.

Shumë shpejt kjo zhurmë u bë njësh me zemërimin tim.

Më dukej sikur më kishin dënuar. Dhe e meritoja. Nuk kisha forcën që kishte im atë kur nëna ime i sillej në këtë mënyrë. Për fat të keq, nuk i ngjaja.

Babai im, po. Ai ishte burrë i vërtetë. E rrihte nënën time sa herë të donte, bridhte me gra të tjera dhe kur ajo e merrte vesh dhe i ankohej, atëherë e mbyste në dru.

Ende më kujtohet se si rrihte zemra ime kur kthehej nga puna në shtëpi në darkë. Kisha tmerrësisht frikë. Sepse më merrte me pahir që të flija në krevatin e tij. Jo, asnjëherë nuk më shqetësoi seksualisht. As nuk më rrihte. Por nuk doja të flija me të. Doja krevatin tim, dhomën time. Dhe frymëmarrja e tij kutërbonte nga pija e tepërt dhe cigaret.

Përveç të tjerave, edhe gërhiste.

Një herë bëra gabim duke kundërshtuar që të shtrihesha në krevatin e tij dhe ma fiku cigaren në dorë. Dhjetë vjeç mund të isha atëherë. Pastaj më kërkoi falje, sigurisht, por akoma nuk mund ta harroj dhimbjen që ndjeva.

Dhjetë vjeç isha atëherë.

Por e fala. Sepse përpiquej të më bënte të kuptoja se burrat mund të bëjnë ç'të duan. Dhe, madje, kur nëna bëri gabimin dhe mbetej sërish shtatzënë, iu lut me mirësjellje që ta abortonte fëmijën.

- Më mjafton Jasoni. Nuk dua fëmijë tjetër. E kuptove? Nesër, që herët në mëngjes, të shkosh te mjeku që ta abortosh, - i tha.

Ose e urdhëroi, më mirë të themi.

Nëna bëri gabimin ta kundërshtonte. Dhe atëherë babai i dha një grusht të fortë në bark me qëllim që ta dështonte fëmijën.

Dhe ia arriti.

Nëna u mbyt në gjak. E çoi ai vetë në spital. Dhe unë mbeta në shtëpi që të pastroja kuzhinën. Nga gjaku

i nënës sime. Nuk doja që babai ta shihte dyshtemenë me gjak kur të kthehej.

U deshën dy javë që nëna të kthehej në shtëpi. Për pak sa nuk e humbëm nga hemorragjia e madhe. Por me të filluar ankesat, me kundërshtimin më të parë për ato që kërkonte im atë, vazhdonte të valonte druri.

Vetëm kështu marrin vesh gratë. Nëse u lë dorë të lirë, e humbe lojën.

Duhet të të kenë frikë. Të dridhen prej teje.

Për fat të keq, nëna ime nuk vinte mend, nuk e pranonte epërsinë e babait tim, dhe kështu vitet e mia të fëmijërisë u stigmatizuan nga zënkat e tyre të vazhdueshme. Kujtoj me tmerr ato net kur babai ikte nga shtëpia dhe nëna më merrte në prehër duke qarë. Por, a s' ishte grua? Përse nuk mund të kuptonte se meshkujt ndryshojnë nga femrat?

Përse nuk e linte të qetë burrin e saj të bënte ç'të donte?

Ah, more baba, kudo që të gjendesh tani, nuk të dëgjova. Nuk e zhdëpa në dru Stelën. E kundërta, u tregova i butë me të. I dhashë të drejtën të bënte ç'të donte me mua. Dhe tani po e paguaj. Në vend që të gjendem në breg të detit në qejfin tim, të admiroj trupat e zhveshur e të bukur duke kaluar para meje dhe të shijoj koktejin tim nën çadër, e lashë veten të më komandonte një grua.

E kush? Unë!

Për fat të keq, nuk kam trashëguar karakterin tënd. Vendosmërinë tënde. Nëna thoshte që ishe i dhunshëm.

Edhe? A bëhej gjithnjë ajo që doje ti? Bëhej.

Duhej që edhe unë të gjeja mënyra që ta bëja Stelën të më respektonte. Mënyra të tilla që gjithmonë të bëhej ajo që doja unë.

Por mos ki frikë për mua, baba. Do t'ia dal, do ta shohësh.

Mora përsëri frymë thellë që të qetësohesha. Ecja nën një urë të gurtë, që ishte e rrethuar nga kaktuse dhe që të çonte në kështjellën e vjetër të portit. Këtu kishin vendosur kavaletat shumë piktorë të *pleinair-it*, të gatshëm për të skicuar portrete.

Ishin të shumtë. I harrova menjëherë vitet e mia të fëmijërisë, kujtova “Montmartre”-in, një nga lagjet më piktoreske të Parisit, dhe piktorët e saj.

Të gjithë piktorët e *pleinair-it* këtu në Ko ishin të huaj. Mjaft njerëz i sodisnin teksa ata punonin. Përdornin karbon, bojëra uji apo lapsa të zakonshëm. Nëna, së bashku me fëmijët e tyre, prisnin me durim në radhë që të fiksoheshin përgjithmonë, por edhe çifte të dashuruar me një buzëqeshje të pikturuar në buzë. Me atë buzëqeshje idiote, buzëqeshjen e matufepsur të dashurisë. A thua se dashuria ekziston dhe nuk është e shkruar vetëm në përralla.

Ishte pasdite herët. Dielli nuk digjte dhe aq shumë. Mora drejtimin për nga porti, duke ecur bregut të detit. Tragetet për udhëtime turistike, kaiket dhe jahtet e mëdha ishin të panumërta. Njëri më i bukur se tjetri. Në mol, para trageteve, ishin vendosur pankarta me fotografi që reklamnin destinacione të ndryshme.

Pjesa dërrmuese e tyre bënin ekskursionet ditore në Turqi, Bodrum dhe Arikarnasonën e lashtë. Të tjerë udhëtonin deri në Kalimno, me stacion të ndërmjetëm në Pserimo dhe Plati.

“Pserimo është një thesar i fshehur, një ishull i vogël me plazhe magjepsëse me rërë, banorë të paktë në numër dhe ujëra të kristalta. Plati është një ishull mikroskopik i pabanueshëm, ku mund të notoni, të peshkoni dhe të...”, thërriste me një pamje të ngrysur një i ri në hyrje të një kaikeje.

Iu afrova.

- Në Kalimno shkoni? - e pyeta.

- Sigurisht, zotëri. Nisemi çdo mëngjes në orën nëntë. Kthehemi përsëri në Ko pasdite, pasi më parë...

- Nuk dua të kthehem. Dua të shkoj në Kalimno tani, - e ndërpreva.

- Atëherë do t'ju duhet të merrni tragetin e linjës, - më këshilloi.

- E kur niset? - e pyeta përsëri.

- Pyesni tek agjencia turistike. Është përballë, - më tha djaloshi dhe rendi drejt disa turistëve që interesoheshin për ekskursionet e tij.

Përshkova rrugën, duke pasur kujdes të mos më merrnin me vete biçikletat dhe motorët e panumërt, dhe u futa tek agjencia turistike. Pa hezituat aspak, preva një biletë për Kalimno me traget. Vinte nga Rodos dhe do të mbërrinte në portin e Kosë për një orë e gjysmë afërsisht. I duhej edhe një orë tjetër që të ankorohesh në Kalimno.